



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT, SHËNDETIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2021

Lënda: Kthim përgjigje

ZNJ. _____

Në përgjigje të shkresës suaj administruar nga ana jonë me nr. 20669 prot. datë 24.11.2021, ju sqarojmë si më poshtë:

1. Informacioni për qytetarët në lidhje me thirrjet për programet e strehimit që zbaton Bashkia Shkodër publikohen në faqen zyrtare të bashkisë: “bashkiashkoder.gov.al” si dhe ka një specialist të strehimit pranë zyrës me një ndalesë që ofron informacion dhe asistencë për qytetarët që janë të interesuar të aplikojnë për strehim.
Linqet:

https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Njoftim_Kriteret_procedurat_dhe_dokumetacioni_per_te_perfituar_nga_Programi_i_Strehimit_Social_ne_zbatim_te_projektit_Rikonstruksion_i_g_2020_1.php

https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Njoftim_Kushtet_procedurat_dhe_dokumetacioni_per_te_perfituar_nga_programet_e_strehimit_social_1829_1.php

https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/THIRRJE_P_R_APLIKIME_Pronar_social_1_1809_1.php

https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Njoftim_Kriteret_procedurat_dhe_dokumetacioni_per_te_perfituar_nga_Programi_i_Strehimit_Social_per_komunitetin_Rom_ne_zbatim_te_projektit_1771_1.php

https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Njoftim_Kushtet_procedurat_dhe_dokumetacioni_per_te_perfituar_nga_programet_e_strehimit_social_1583_1.php

https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Njoftim_per_shtyrjen_e_afateve_te_procedurave_te_aplikimit_dhe_te_zbatimit_te_programeve_sociale_te_strehimit_1594_1.php

https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Njoftim_Rihapen_Aplikimet_per_Programet_e_Strehimit_Social_1654_1.php

2. Bashkia Shkodër zbaton tre programe të banesave sociale me qira:

a. Banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për familjen nr. 6” e dedikuar për jetimët që dalin nga institucionet dhe familjet një prindërore, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me ministrinë e linjës, ku janë në dispozicion 24 apartamente sociale me qira: garsonierë, 1+1 dhe 2+1.

Qiraja sociale mujore e miratuar për këtë program është:

- apartament A me sip. 56.8 m² është 3264 lekë/muaj;
- apartament B me sip. 88.9 m²=5109 lekë/muaj;
- apartament C me sip. 96.1 m²=5523 lekë/muaj

Banesat sociale për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetin rom, ku janë në dispozicion 27 apartamente me qira 1+1 dhe 2+1. Qiraja sociale mujore e miratuar për këtë program është:

- apartament 1+1 është 1,900 lekë/muaj;
- apartament 2+1 është 2,500 lekë/ muaj.

Banesa sociale me qira pranë ish konviktit të shkollës Veterinare, ku janë në dispozicion 28 banesa 1+1 dhe 2+1. Jemi në proces të miratimit të listës së përfituesve dhe të qirasë sociale për këtë program.

b. Bashkia Shkodër nuk ka në zbatim programin e Banesave me Kosto të Ulët, por ka në zbatim Instrumentin financiar “Subvencionimi i interesave të kredisë”. Për këtë program bashkia Shkodër në vitin 2020 ka patur në dispozicion 100 kuota. Janë miratuar 179 përfitues, nga të cilët kanë arritur të lidhin kontratën me institucionin financiar deri tani 26 përfitues.

Gjithashtu është akorduar instrumenti financiar “Grant i menjëhershëm” për 3 përfitues të banesave me kosto të ulët.

c. Bashkia Shkodër nuk ka zbatuar programin e banesave të specializuara.

3. Sistemet e pikëzimit miratohen çdo vit në këshill bashkiak për programet që bashkia ka në zbatim. Të gjitha sistemet e pikëzimit janë tash publikuara on line në faqen zyrtare të bashkisë.

https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Vendimet_e_Keshillit_169_1.php/ VKB nr. 12 datë 26.2.2021.

4. Buxheti i disponueshëm për periudhën 2019-2021 është si më poshtë:

- Për vitin 2019 buxheti për programet e strehimit social është 22,778,000 lekë dhe përkatësisht 15,491,000 lekë nga të ardhurat e bashkisë dhe 7,287,000 lekë transferat të kushtëzuara. Vlerat i përkasin buxhetit të realizuar.

- për vitin 2020 buxheti është 793,694 lekë nga të cilat 737,000 lekë janë nga të ardhura e bashkisë dhe 59,694 janë transferta të kushtëzuara. Vlerat i përkasin buxhetit të realizuar.

- për vitin 2021 buxheti i planifikuar është 87,935.000 lekë, nga të cilat 34,484,000 lekë janë të ardhurat e bashkisë dhe 53,451,000 lekë janë transfertë e kushtëzuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR

Voltana ADEMI